

Fjala e kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, akademik Hivzi ISLAMI me rastin e dorëzimit të Fletëdëshmisë Prof. Dr. Matteo Mandalàsë, anëtar i jashtëm i Akademisë

Të nderuar studiues dhe miq,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni në fillim t'ju uroj punë të mbarë në këtë Konferencë shkencore të organizuar nga Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Është një rast i rrallë të tubosh në një vend emrat e njohur të albanologjisë rreth një teme bosht - *“Studimet albanologjike në n; vendet ku flitet gjuha gjermanisht”*. Nuk ka asnjë dyshim se me trajtesat, kontributet dhe faktet që do t'i kumtoni këto dy ditë, do të sillni rezultate të rëndësishme për shkencën e albanologjisë dhe më gjerë. Rëndësia pasuese e kësaj Konference qëndron në nxjerrjen në dritë të kumtesave dhe diskutimeve, me botimin e tyre në një vëllim të veçantë ashtu siç vepron Akademia jonë dhe natyrisht prof. Rexhep Ismajli, sepse pa të nuk bëhen këto punë.

Akademia jonë që nga themelimi para 42 vjetësh pranon dhe anëtarë të jashtëm të saj. Sipas Ligjit, në këtë status “mund të zgjidhen punonjësit e shkencës ose të artit që jetojnë dhe veprojnë jashtë vendit, të cilët kanë krijuar vepra të rëndësishme për Kosovën, ose vepra me vlerë të përgjithshme për shkencën ose artin”. Kjo Akademi ka zgjedhur anëtarë të jashtëm nga katër anët e botës, emra të mëdhenj të albanologjisë, ballkanologjisë, linguistë të spikatur në rrafshin teorik, figura të njohura të shkencave të natyrës, të shkencave shoqërore dhe të arteve. Në këtë sallë i kemi disa prej tyre, ndër albanologët më të shquar sot: Prof. Wilfried Fiedleri, Prof. Bahri Beci dhe Prof. Francesco Altimari.

Në zgjedhjet e fundit në dhjetor të vitit 2016, Kuvendi i Akademisë, me propozim të Seksionit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, zgjodhi anëtar të jashtëm edhe Prof. dr. Matteo Mandalànë. Dhe sot, dua të përfitoj nga ky rast i veçantë që t'i ndaj, para jush, prof. Mandalàsë, fletëdëshminë e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Prof. Matteo Mandalà, studiues i letërsisë arbëreshe dhe i asaj shqiptare në përgjithësi, por edhe i gjuhës, dialektologjisë, kulturës dhe traditave arbëreshe, profesor i Universitetit të Palermos, është një nga personalitetet më të rëndësishme të shkencës dhe kulturës arbëreshe, por edhe i filologjisë shqiptare në përgjithësi. Bota e Arbëreshëve të Italisë prof. Francesco Altimarin dhe Prof. Matteo Mandalànë, i konsideron themelues të filologjisë moderne arbëreshe, personalitete nga më të vlerësuarit të studimeve për gjuhën, letërsinë e vjetër arbëreshe dhe shqiptare përgjithësisht, nga fillimet e deri më sot, për kulturën dhe traditën arbëreshe dhe për arsimimin, vetëdijesimin e qenies dhe identitetit arbëresh në Itali. Andaj ishte një kënaqësi, por edhe nder e privilegj që t'i kemi në mesin e anëtarëve të jashtëm, më të respektuar, të shkencave të albanologjisë.

Duke mos dashur t'ju shkëpus më shumë nga aktiviteti, për të cilin jeni tubuar këtu, ftoj prof. dr. Matteo Mandalànë ta marrë fletëdëshminë e anëtarit të jashtëm të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Në Prishtinë, më 26.10.2017